

**PËLLUMB XHUFI****GJURMË TË PRANISË SË HEBREJVE NË SHQIPËRI  
GJATË MESJETËS**

Shekulli XVI ofron një panoramë befasuese për sa i përket pranisë së elementit hebraik në Shqipëri. Poli kryesor i pranisë së komuniteteve hebraike në këtë kohë ishte padyshim Vlora. G. Veinstein ka sinjalizuar tashmë rëndësinë e faktorit hebre në Vlorë, në bazë të të dhënave të Regjistrimit (Sixhilit) të Kadiut të Vlorës të viteve 1567/1568<sup>1</sup>. Gjë që e kishte paralajmëruar, madje në mënyrë më të plotë e të saktë, Regjistri osman i pronave dhe i popullsisë së sanxhakut të Vlorës i vitit 1519/1520: sipas tij, vetëm në qytetin e Vlorës, me gjithsej 1558 familje, në atë vit kishte 528 familje hebre, krahas 945 familjeve të krishtera e 85 muslimane<sup>2</sup>. Sigurisht, duke konsideruar natyrën e ndryshme të dy regjistrave osmanë të sapopërmendur, çdo konkluzion mbi bazën e krahasimit të tyre do të çalonte. Megjithatë, sixhili i përmendur i vitit 1567/8 na jep të kuptojmë se në atë kohë, pjesa e popullsisë hebraike nuk ishte më ajo e gjysëmshkulli më parë. Por, duhet thënë se jo pak hebregj të Vlorës, por kjo vlen edhe për hebregjtë e Beratit<sup>3</sup>, në atë kohë ishin konvertuar në Islam<sup>4</sup>. Islamizimi i hebregjeve të Vlorës e të Beratit njohu

<sup>1</sup> G. Veinstein, *Une communauté ottomane: les Juifs d'Avlonya dans la deuxième moitié du XVI siècle*, në: "Gli Ebrei e Venezia sec. XIV-XVIII", bot. G. Cozzi, Milano, 1987, f. 781-828.

<sup>2</sup> Ferit Duka, *Realiteti etnik i Dropullit në burimet historike të shek. XVI sipas Defterit osman i regjistrimit të pronave dhe të popullsisë së sanxhakut të Vlorës i vitit 1520*, në: "Studime historike", 3-4, Tiranë, 1991, f. 167-199; G. Veinstein, *Une source ottomane de l'histoire albanaise: le registre des Kadi d'Avlonya 1567-1568*, në: "The Medieval Albanians, Institute for Byzantine Research", International Symposium 5, Athens, 1998, f. 375, n.12.

<sup>3</sup> Mbi komunitetin hebraik të Beratit në shek. XVI-XVIII, shih: Ferit Duka, *Berati në kohën osmane (shek. XVI-XVIII)*, Tiranë, 2001, f. 24-30, 237-238, 262.

<sup>4</sup> G. Veinstein, *Une source ottomane ....*, f. 383.

një fazë më intensive në kohën kur, me lejë të Vezirit të Madh, shqiptarit Fazli Ahmed Qyprili që ishte admirues i tij, mes viteve 1666-1676, këtu erdhi e jetoi “mesia i remë” Sabatah Zevi<sup>5</sup>. Përhapës i një doktrine mistike e synkretike në një kohë të karakterizuar nga perturbacione politike<sup>6</sup>, heterodoksi Zevi ndërtoi një raport të ngushtë në Shqipëri, veçanërisht me bektashijtë shqiptarë, ndjekës gjithashtu të një besimi heterodoks e synkretik<sup>7</sup>. Në një moment të caktuar të qëndrimit të tij në Shqipëri, Zevi u konvertua në islam, duke tërhequr nën shembullin e tij edhe hebretë të shumtë të atyshëm<sup>8</sup>.

Kjo prani mbresëlënëse e popullsisë hebraike në qytetet shqiptare në kapërcim të shekujve XV-XVI, i detyrohet diasporës sefardike të vitit 1492, kur grupe të tëra hebresh u hodhën në brigjet shqiptare pasi lanë Spanjën apo edhe vendbanimet e tyre në Italinë e Jugut e në Siqili, ku gjithashtu shtrihej pushteti i mbretit antisemit, Ferdinandit të Kastiljes<sup>9</sup>.

Megjithatë, hebretë në Shqipëri dëshmohen shumë më herët se shek. XVI. Në këtë botim, M. Korkuti na informon për një të dhënë të vitit 520 nga Lecce e Italisë, ku flitet për një bashkësi hebree nga ky qytet, që lidh krushqi me një bashkësi tjetër hebree nga Onchesmos. Gjithnjë lidhur me këtë argument, vite më parë, profesori i Universitetit të Barit, Cesare Colafermina, gjurmues i njohur i kulturës hebraike në Italinë e Jugut, na ka informuar për zbulimin e një mbishkrimi në hebraisht nga Kalabria. Mbishkrimi i përket shek.VI dhe aty përmendet një hebre i shpërngulur në Kalabri nga Onchesmos (Saranda) e

<sup>5</sup> M. Balivet, *Byzantins et Ottomans*, Istanbul (Isis), 1999, f. 73-74; Robert Mantran, *Histoire de l'Empire Ottoman*, Paris, 1989. Ne i kemi referuar botimit shumë të mirë shqip: *Historia e Perandorisë Osmane*, “Dituria”, Tiranë, 2004, f. 235.

<sup>6</sup> G. Scholem, *Sabbatai Sevi, the mystical messiah*, Princeton, 1973; H. H. Ben-Sasson, *vep. e përm.*, München (C. H. Beck Verlag), 1992, f. 858-864.

<sup>7</sup> M. Balivet, *vep. e përm.*, f. 56-61, 176-178.

<sup>8</sup> H. H. Ben-Sasson, *vep. e përm.*, f. 862-864; R. Mantran, *vep. e përm.*, f. 235; M. Balivet, *vep. e përm.*, f. 177. Po tërheqim vëmendjen e lexuesit tek një varr monumental i shek. XVII, që ekziston sot e kësaj dite në fshatin Tragjas i Vjetër. Nisur nga tipologjia, varri i përket padyshim një dinjitarit osman. Por, prania e yllit të Davidit të gdhendur në ballë të tij, mund ta lidhë të varrosurin me përkrahësit e Sabatah Zevit, në mos me atë vetë.

<sup>9</sup> H. H. Ben-Sasson, *vep. e përm.*, f. 774, ku flitet për vendosjen e katër komuniteteve hebree në qytetin e vogël epirot të Artës dhe për marrëdhëniet e mira me vendasit.

Shqipërisë. Mbishkrimi në fjalë konfirmon faktin e njohur se në këtë kohë Onchesmos u shkatërrua nga barbarët, pushoi së ekzistuari si qendër urbane dhe se një pjesë e popullsisë e tij, ku nuk mungonin edhe hebretë, gjeti shpëtim në brigjet fqinje të Italisë<sup>10</sup>. Kjo dëshmi epigrafike, duket se gjen konfirmim edhe në zbulimin e paradokohshëm të rrënojave të një sinagoge, në qendër të tregut të Sarandës së sotme, e cila, bashkë me bazilikën aty afër, ruan shenjat e djegies e të rrënimit që qyteti pësoi pikërisht në kohën e dyndjeve barbare, prej të cilave nuk e mori më veten<sup>11</sup>.

Në shekujt pasardhës, grupe popullsish hebraike dëshmohen në qendrat bregdetare, të cilave i referohet kryesisht dokumentacioni historik. Gjë që nuk përjashton mundësinë që hebretë të ishin vendosur edhe në qendra urbane të zonave të brendshme, siç na dëshmohen në qytetin e Beratit në epokën osmane<sup>12</sup>. Por në shekujt paraardhës, qendra që kishte tërhequr më së shumti praninë e hebrevje, ishte qyteti bregdetar i Vlorës. Qysh në kohën e pushtimit nga Manfredi Hohenshtaufen i Siqilisë, më 1258, Vlora fitoi një rol të veçantë në krejt zonën adriatiko-joniane për tregtinë e beharnave, që vinin nga Afrika e Veriut, posaçërisht nga emirati i Tunizisë<sup>13</sup>. Në shek. XIII-XIV, sundimtarët e Vlorës mbanin marrëdhënie të rregullta me emirët e Tunizisë dhe në themel të këtyre marrëdhënieve ishte pikërisht importi i beharnave, që më tej rieksportheshin drejt Raguzës e Venedikut<sup>14</sup>. Ndonëse nuk kemi të dhëna direkte, ne mund të pohojmë se në këtë tregti të veçantë të zotërve të Vlorës ishin përfshirë edhe tregtarë hebregj. Kujtojmë që një koloni e tërë hebraike e njohur për kultivimin dhe tregtimin e beharnave, ishte shpërngulur nga paraardhësi i Manfredit, Frederiku II, nga Jerba e

<sup>10</sup> Neritan Ceka, *Ilirët*, Tiranë, 2001, f. 253, 277.

<sup>11</sup> Neritan Ceka, *The Illyrians to the Albanians*, Tiranë, 2005, f. 287, 306.

<sup>12</sup> F. Duka, *vep. e përm.*, f. 24-30, 237-238, 262. Sipas udhëtarit osman Evlija Çelebi, në shek. XVII varoshi i Beratit kishte, mes tridhjetë lagjeve, edhe një lagje hebreë. Shih: Evlija Çelebi, *Shqipëria para tre shekujsh*, "Besa", Tiranë, 2000, f. 56.

<sup>13</sup> Pëllumb Xhufi, *L'aggancio all' Est: Manfredi Hohenstaufen in Albania*, in: "Oriente e Occidente tra Medioevo e Età moderna", Studi in onore di Geo Pistarino, bot. L. Balletto, vëll. II, Genova, 1997, f. 1252.

<sup>14</sup> A. Solovjev, *Un beau-frère du tsar Dousan*, në: "Révue Internationale des Études Balkaniques", 1 (1934), f. 180-187.

Tunizisë në Siqili<sup>15</sup>. Dhe, nëse pas pushtimit të Vlorës e të qendrave të tjera bregdetare të Shqipërisë nga Manfredi, në 1258, mjaft shtetas të tij italianë u larguan nga Mbretëria e Siqilisë e u vendosën në bregun tjetër të Adriatikut<sup>16</sup>, ne mund të besojmë se një “migrim” i tillë brendapërbrenda zotërimeve të Manfredit, pra nga Sicilia drejt Shqipërisë Hohenstaufen, mund të ketë prekur edhe komunitetin hebraik të Sicilisë<sup>17</sup>.

Më tej, Vlora përmendet edhe për prodhimin e një kripe të cilësisë së veçantë, *sal albus* (kripa e bardhë)<sup>18</sup>. Me tregtinë e këtij produkti lidhet edhe hebreu i parë, me emrin David, që përmendet në vitin 1368 teksa furnizonte me kripën e Vlorës deri edhe tregjet e Raguzës. Në transaksionet që Davidi zhvillon me tregtarë raguzanë, shfaqen vazhdimisht në rolin e ortakut apo të dëshmitarit, të tjerë qytetarë hebrej, si: Musku, Mateu, Sandrus e Lazari, kushëri i Davidit, që e shoqëronte këtë në udhëtimet e tij të transportit të kripës për Raguzë<sup>19</sup>. Në vitet 1414, pra në prag të pushtimit osman të qytetit, në Vlorë përmendet hebreu Solomon, djemtë e të cilit, Gratiadei dhe Leoni, merreshin me “ushtrimin e tregtisë” (*exercitium mercantie*)<sup>20</sup>. Këtë zanat ushtronin shumica e hebrejve, që arrijnë të evidentohen në dokumentacionin mesjetar në dispozicionin tonë. Në vitin 1430, hebreu nga Vlora, Gozio, ishte bërë pikë referimi për transaksionet e drithit me tregtarët venecianë<sup>21</sup>. Dhe si të gjithë ata që zotëronin mall e pasuri dhe që mu për këtë arsye bëheshin objekt dhe pré e grabitësve, edhe hebrejtë tanë pësonin sulme e plaçkitje,

<sup>15</sup> D. Abulafia, *Frederick II: a medieval Emperor*, London, 1988, f. 146, 335-336.

<sup>16</sup> Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, Tiranë, 2006, f. 121-122, 128-130.

<sup>17</sup> D. Abulafia, *The two Italies: economic relations between the Norman Kingdom of Sicily and the Northern Communes*, Cambridge Univ. Press, 1977, f. 25-26, 42-48, 266-267.

<sup>18</sup> Ludovicus de Thalloczy, Constantinus Jireček, Emilianus de Šufflay, *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia* (më tej: *Acta Albaniae*), vëll. II, Vjenë, 1918, nr. 221; A. Ducellier, *La façade maritime de l'Albanie au Moyen âge*, Tessalonike, 1981, f. 594, 641 shën. 1060: “*de bono sale albo de Avelona*”.

<sup>19</sup> *Acta Albaniae*, II, nr. 248.

<sup>20</sup> G. Valentini, *Acta Albaniae Veneta*, pars 2, tomus VII, nr. 1918, f. 166-167.

<sup>21</sup> Oliver J. Schmitt, *Arbëria Venedike (Das venezianische Albanien) 1392-1479*, bot. shqip, Tiranë, 2007, f. 446.

ku jo rrallë përziheshin edhe zotër me emër<sup>22</sup>. Kështu, nga një vendim i Senatit të Venedikut i vitit 1398, mësohet se një tregtar hebre nga Korfuzi, me emrin Mordach, ishte sulmuar në zonën e Butrintit nga njerëzit e despotit shqiptar Gjini Bua Shpata. Dëmi arrinte në 178 hyperperë dhe hebreu Mordach, që për më tepër ishte shtetas venecian, nuk pushoi së kërkuari nga autoritetet veneciane, për muaj e vite me rradhë, që të gjendej mënyra për t'i shlyer dëmin. Dhe më në fund, Senati, i cili duket se u bezdis jo pak nga ndërhyrjet këmbëngulëse të Mordachut, vendosi që të vinte në veprim forcën dhe të sekuestronte prona e pasuri, nga ato që despoti Shpata e shtetasit e tij kishin në Korfuz, në vlerën e 178 hyperperëve<sup>23</sup>.

Në Durrës, “metropol i Ilirikut”, dëshmohej një konsistencë dhe vazhdimësi më e plotë e pranisë së hebrenjve. Për rolin dhe rëndësinë e tij, Durrësi kishte përmasat e një kozmopoli: aty gjeje banorë e bujtës të huaj, sa bizantinë, aq edhe venecianë, amalfitanë, raguzanë, gjenovezë etj. Nuk mund të mungonin edhe hebretë. Në vitin 1322, udhëtari anglez Symeon Symeonis qëndroi në Durrës, ku njofton praninë e një komuniteti “hebrejsh dinakë” (*perfidis hebreis*)<sup>24</sup>. Mbi madhësinë e këtij komuniteti thotë diçka më shumë një dokument i mëvonshëm i vitit 1401, sipas të cilit në Durrës kishte pak familje hebre, edhe këto të varfra (*judei habitatores Durachii, quia sunt pauperes et pauce familiae*)<sup>25</sup>. Pavarësisht se kjo dëshmi meriton një analizë të veçantë, gjë që do ta bëjmë më poshtë, mund të pranojmë që në këtë kohë ka ndodhur një tkurrje e popullsisë hebre, ashtu si ndodhi në përgjithësi me popullsinë e Durrësit për shkak të rrethanave të trazuara politike: në tridhjetë vitet e fundit të shek. XIV, Durrësi kaloi nëpër duart e Anzhuinëve, të princërve

<sup>22</sup> Përndryshe, komuniteti hebraik ka gëzuar status e mbrojtje të veçantë në gjithë “Romaninë” bregdetare. Kështu, në vitin 1324 dëshmohej privilegjet e lëshuara në favor të popullsisë hebraike nga Filipi I i Tarentit, të cilat u konfirmuan edhe nga mbreti Robert Anzhu në 1336 dhe më vonë, në 1370 edhe nga Filipi II i Tarentit. Sipas dispozitave në fjalë, zyrtarëve anzhuinë u ndalohej të sekuestronin kafshët e pasuritë e hebrenjve, si dhe të fyeshin e të pengoheshin këta në ushtrimin e rriteve të tyre fetare. Shih për këtë: J. Buchon, *Nouvelles Recherches*, vëll. I, f. 408-413; A. Kiesewetter, *I principi di Taranto e la Grecia*, në: “Archivio Storico Pugliese”, viti 54, fash. 1-4, janar-dhjetor 2001, f. 92.

<sup>23</sup> G. Valentini, *Acta Albaniae Veneta*, pars I, tomus 3, f. 82, 116.

<sup>24</sup> A. Ducellier, *vep. e përm.*, f. 752.

<sup>25</sup> *Acta Albaniae*, vëll. I, nr. 676; G. Valentini, *Acta Albaniae Veneta*, pars I, tomus 3, f. 275; A. Ducellier, *vep. e përm.*, f. 528.

Topia, të Venedikut, ndërkohë që qysh prej vitit 1385 turqit shfaqeshin herë pas here kërcënueshëm para portave të tij<sup>26</sup>. Megjithatë, gjendja duhet të kishte qenë e ndryshme në vitet e në shekujt e shkuar. Për një prani domethënëse të hebregjeve në Durrës flet qartë një dokument i vitit 1417, ku përmendet, për herë të parë, një “*Judaica Durachii*”<sup>27</sup>. Me këtë emër, *Judaica* (në Venedik: *Giudecca*), quheshin në mesjetë lagjet e qyteteve italiane të rezervuara për hebregjtë<sup>28</sup>. Që në Durrës të kishte një lagje të veçantë për hebregjtë<sup>29</sup>, kjo s’do të përbënte, në fund të fundit, ndonjë zbulim për një qytet të madh e me prani komunitetesh të huaja, siç ishte qyteti-port i Adriatikut<sup>30</sup>. Qysh herët këtu dëshmohet prania e komuniteteve të huaja<sup>31</sup>. Në shek. XI në Durrës ekzistonte një lagje veneciane, e zhvilluar përreth kishës së Shën Andreas<sup>32</sup>. Një koloni tregtarësh nga Amalfi i Italisë ekzistonte gjithashtu në Durrës atë kohë<sup>33</sup>.

<sup>26</sup> Shqetësimi nga inkursionet turke ishte aq i madh, sa që në 1392 Senati i Venedikut projektoi hapjen e një kanali të gjerë që do ta ndante Durrësin nga prapatoka dhe do ta kthente atë në një ishull, shih: *Acta Albaniae*, II, nr. 481, 488, 500, 514.

<sup>27</sup> *Acta Albaniae Veneta*, pars II, tomus 8, f. 404.

<sup>28</sup> Shih për këtë: *L’Enciclopedia*, vol. 22: Dizionario di Italiano, ed. La Repubblica, Roma, 2004, f. 1315.

<sup>29</sup> Lagja hebraike e Durrësit në çdo rast duhej të ishte jashtë mureve të qytetit, duke imituar pak a shumë shembullin e lagjes së hebregjeve të Venedikut, Giudecca. Në fakt, dokumenti i cituar flet për një urdhër të bajliut venedikas të Durrësit, Matheo Gradonikut, i cili nxirrte fitime të padrejta, duke i detyruar fshatarët t’i shisnin, vetëm atij dhe me çmime të imponuara nga ai vetë, mshikëzat e mëndafshit, që ata tregtonin “sa në Durrës, aq edhe në lagjen hebraike të Durrësit” (*tam in Durachio, quam in Judaicha Durachii*). Shih: *Acta Albaniae Veneta*, pars II, tomus 8, f. 404. Mbi prodhimin e tregtinë e mëndafshit në zonën rreth Durrësit, shih: M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens während des Mittelalters*, München und Leipzig, 1924, f. 42.

<sup>30</sup> Kujtojmë që në shek. XVII udhëtari turk Çelebi dëshmon për një lagje të banuar nga hebregjtë në Berat, shih: E. Çelebi, *vep. e për.*, f. 56.

<sup>31</sup> J. Gay, *L’Italie méridionale et l’Empire byzantin*, Paris, 1904, f. 585.

<sup>32</sup> Anne Comnène, *Alexiade*, bot. Leib, vëll. II, Paris, 1946, f. 7; G. Tafel-G. Thomas, *Urkunden zur alteren Handels-und Staatsgeschichte der Republik Venedig*, I. Band, Wien, 1856, f. 52.

<sup>33</sup> Anne Comnène, *vep. e për.*, f. 7; D. Abulafia, *The two Italies ...*, f. 48-49.

Edhe këta kishin, ashtu si venedikasit, lagjen e tyre, që shpalosej përreth kishës së tyre të veçantë, Shën Mërisë së Amalfitanëve<sup>34</sup>.

Tregtarët hebregj luanin një rol të rëndësishëm në trafiqet tregtare që zhvilloheshin nga dhe për në Durrës. Tregtia e kripës kontrollohej në një masë të mirë prej tyre. Këtë lë të kuptojë një dokument i vitit 1319, i cili bën fjalë për një tregtar hebre, që nëpërmjet manipulimit me çmime më të ulta (10 hyperperë për masë qindshe), kishte pushtuar tregun e kripës në qytetin e Durrësit, duke ngjallur mërinë e qeveritarit anzhuin të qytetit, që pretendonte monopolin në këtë sektor<sup>35</sup>. Të njëjtin aktivitet ushtronin vite më parë, më 1281, dy tregtarë hebregj nga Durrësi, Michel e Leon de Chura Chalia<sup>36</sup>. Edhe këta duhet të bënin shumë marifete për t'i shpëtuar kontrollit të qeveritarit anzhuin dhe për të eksportuar kripën e tyre në Venedik. Një numër tregtarësh hebregj nga Durrësi përmenden edhe në vitin 1360: "*Muxie fio fo de Samuel zudio; Mischio zudio; Cahili zudio; Donado çudio; Manichelo zudio sacerdote; Josaphat zudio*" (Mukshi, djalë i të ndjerit Samuel, hebre; Misko, hebre; Kahil, hebre; Donati, hebre; Manikeli, prift hebre (dmth. rabin); Jozafati, hebre)<sup>37</sup>. Përveçse tregtarë, judejtë e Durrësit merreshin edhe me menazhimin e parasë, duke financuar hera-herës edhe veprimtari publike për llogari të qeveritarëve të vendit. Kështu, në vitin 1417, një hebre me emrin Sanson mori përsipër të japë pagat e ushtarëve të garnizonit të Durrësit. Në fakt, pagesa u krye duke mos dhënë të holla, por një sasi cohe, e cila për më tepër u llogarit me dyfishin e çmimit të tregut. Sigurisht, këtu kemi të bëjmë me një histori korrupsioni, prapa së cilës qëndronte bajliu famëkeq venedikas i Durrësit, Matteo Gradoniku, i cili sigurisht vilte fitimin. Nga ana e tij, hebreu Sanson është pjesë e kësaj historie, nga e cila mund të ketë nxjerrë edhe ai fitimin e tij. Por më shumë se të fitonte ndonjë dukat nga ato që i lëshonte bajliu, Sansonit i interesonte më shumë të fitonte miqësinë apo dashamirësinë e qeveritarit venedikas, nga humoret e të cilit varej fati i aktivitetit të tij. Përveçse tregtarë apo bankierë, hebregjtë në Durrës i gjejmë edhe midis shtresës së zejtarëve. Kështu, në vitin 1363 flitet për një mjeshtër hebre: "*David magistri Judayoe de Durachio*". Por nuk sqarohet profesioni i ushtruar prej tij.

<sup>34</sup> A. Ducellier, *vep. e për.*, f. 71.

<sup>35</sup> *Acta Albaniae*, I, nr. 652; A. Ducellier, *vep. e për.*, f. 280.

<sup>36</sup> A. Ducellier, *vep. e për.*, f. 282-283.

<sup>37</sup> O. J. Schmitt, *vep. e për.*, f. 128.

Nga të dhënat e tjera që kemi mbi komunitetin hebraik të Durrësit, rezulton se gjendja ekonomike dhe statusi social i hebregjeve ishte mjaft i lartë. Përfaqësuesit e këtij komuniteti i gjejmë më së shumti, si: tregtarë, financierë, zejtarë. Këtij konkluzioni i bie ndesh dokumenti i përmendur i vitit 1401, ku flitet për “hebrej të paktë e të varfër” në Durrës. Por, kujdes: në këtë rast kemi të bëjmë me një kërkesë që një përfaqësi e qytetit të Durrësit i paraqiti Senatit të Republikës së Venedikut, që atë kohë kishte sundimin mbi qytet, për t’i çliruar bashkëqytetarët e tyre hebreg nga një taksë, që tradicionalisht paguhej nga familjet hebreje dhe që konsistonte në dhënien e 16 pashë stofi (catasamiti). Përfaqësuesit e qytetit të Durrësit, duke interpretuar edhe një raport të mirë me hebregjtë e atij qyteti, duhet të kenë gënjyer diçka, kur i përshkruan këta tek Senati i Venedikut si “të paktë dhe të varfër”. Ishte mënyra më e mirë për t’i çliruar hebregjtë durrësakë nga taksa në fjalë.

Në Durrës, eventualisht edhe në Vlorë e në qendrat e tjera urbane, hebregjtë kishin statusin e bujtësit (*morantes*) apo të banorit (*habitatores*), dhe jo atë të qytetarit (*cives*), që e kishin vendasit<sup>38</sup>. Kujtojmë se statusin e “banuesit”, dhe jo atë të “qytetarit”, e kishin edhe sipërmarrësit e shumë venecianë, që në Durrës dëshmohen, siç thamë, qysh prej shek. XI dhe që përfaqësonin aty një komunitet mjaft të respektuar dhe me pushtet jo vetëm ekonomik, por edhe ushtarak. Përgjithësisht, në Shqipëri nuk shquhen gjurmë të qëndrimeve diskriminuese e antisemite, siç ndodhte rëndom në Evropën e krishterë të asaj kohe<sup>39</sup>. Nuk duket të ketë patur përmbajtje antisemite as rasti i rëndë i ndodhur në Durrës në vitin 1448, kur një qytetar durrësak, Nikollë Simaku, rrahu keq një grua hebreje të quajtur Mameksa. Akti duhej të ishte aq i pazakonshëm dhe i dënueshëm, sa që Nikolla u ndëshkua me heqjen e njërit sy<sup>40</sup>! E vetmja dëshmi që do të mund të provonte ekzistencën e risentimenteve

<sup>38</sup> G. Valentini, *Acta Albaniae Veneta*, pars I, tomus 3, f. 275: “*Judei habitatores Durachii*”; O. J. Schmitt, *vep. e për.*, f. 153; A. Ducellier, *vep. e për.*, f. 529.

<sup>39</sup> H. H. Ben-Sasson, *vep. e për.*, f. 590-596; A. Borst, *Lebensformen im Mittelalter*, Frankfurt am Main-Berlin, 1992, f. 600-611; H. Boockmann, *Das Mittelalter*, bot. C. H. Beck, Darmstadt, 1989, f. 235-237; D. Kertzer, *I papi contro gli Ebrei: il ruolo del Vaticano nell’ascesa dell’antisemitismo moderno*, Milano, 2004, f. 94-114.

<sup>40</sup> Megjithatë, ndëshkimi u gjykua i tepruar dhe nuk u ekzekutua: *Acta Albaniae Veneta*, pars III, tomus 20, f. 66.

antisemite, përkatësisht në Durrës, mbetet ajo e “*hebrejve tinzarë*” e udhëtarit Symeon Symeonis, në vitin 1322, për të cilën folëm më parë. Por ky ishte i huaj dhe sigurisht sillte në Durrës paragjykimet e vendit të vet. Nga ana tjetër, në të njëjtin përshkrim, Symeoni nuk shpreh konsideratë më të mirë edhe për vetë shqiptarët, të cilët i quan “barbarë” (*barbaris albanensibus*)<sup>41</sup>. Sigurisht, vlerësimet e Symeonit për hebrenjtë e për shqiptarët reflektojnë dy kategori të ndryshme paragjykimi, që në kohët tona do t’i përgjigjeshin *antisemitizmit* e *ksenofobisë*, ku e para ka ngarkesa dhe riperkusione historike shumë më të rënda se e dyta. Por, përsërisim, tek shqiptarët, një popull i vlerësuar në të gjitha kohrat për tolerancën e vet ndaj minoriteteve<sup>42</sup>, nuk gjenden shenja antisemitizmi as në periudhën në studim. Kjo vlen si për popullin, ashtu edhe për autoritetet. Këto nuk mungonin t’i afronin përfaqësuesit e komunitetit hebraik deri edhe në detyra e poste prestigjioze. Në vitin 1398, despoti i Vlorës Merksha, kishte angazhuar si njeri të besuar e ambasador të vet hebreun vlonjat, Davidin, që përndryshe ushtronte zanatin e tregtarit<sup>43</sup>. Nuk është pa rëndësi të kujtojmë që zotërit shqiptarë, përfshirë edhe vetë Gjergj Kastriotin Skënderben, i zgjidhnin ambasadorët e vet përgjithësisht mes njerëzve të besuar të klerit<sup>44</sup>. Këtu kemi padyshim një tregues të integritit në nivelin më të lartë të hebrenjve në realitetin vendas. Integritim, që ishte akoma më i dukshëm në nivelet e tjera të jetës qytetare. Kështu, njëjloj si qytetarët e tjerë, banorët hebrej shfaqen vazhdimisht si dëshmitarë e garantë në kontratat e lidhura midis qytetarëve të tjerë, jo hebrenj. Kështu ndodh me një kontratë shitblerje kripe mes një tregtari nga Durrësi dhe një tregtari nga Raguzi, në vitin 1366, ku veç të tjerëve asistojnë si garantë e dëshmitarë edhe hebrenjtë e

<sup>41</sup> A. Duceilier, *vep. e përm.*, f. 752.

<sup>42</sup> Pëllumb Xhufi, *Tolleranza religiosa fra tradizione e moderno in una società multiconfessionale*, in: “Bulletin de l’Association Internationale d’Etudes du Sud-Est Européen” 26/27(1996-7), f.153-159.

<sup>43</sup> *Acta Albaniae*, vëll. II, nr. 598. Promovime të tilla të hebrenjve në poste të larta, nuk ishin të jashtëzakonshme në mjedisin venecian (Merksha ishte gjithashtu qytetar i Venedikut): në vitin 1387 një hebre nga Korfuza, David de Sertis, ishte këshilltar i dogjit të Venedikut, Anton Venier. Shih: *Acta Albaniae Veneta*, pars I, tomus 2, f. 36.

<sup>44</sup> Pëllumb Xhufi, *Kleri dhe roli i tij në jetën shoqërore e politike*, në: “Historia e Popullit Shqiptar”, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, vëll. I, “Toena”, Tiranë, 2002, f. 237-238.

Durrësit, Muscus, Matheus e Lazari. Raste të ngjashme dëshmohen edhe në Regjistrin e Kadiut të Vlorës të vitit 1567/8, ku hebrejtë shfaqen në rolin e garantit e të dëshmitarit në lidhjen e kontratave civile mes qytetarëve të krishterë apo mes të krishterëve dhe muslimanëve<sup>45</sup>.

Në fund vlen të thuhet se përsa jemi të dokumentuar, grindjet e përplasjet midis vetë hebrejve përbënin një problem edhe më evident se ato me mjedisin vendas. Kështu, në vitin 1372, regjistrohet në Raguzë një grindje midis hebreut Lazar nga Durrësi, që kishte sjellë aty një ngarkesë kripe, dhe një hebreu tjetër, me emrin Sandrus. Akoma më i rëndë ishte konflikti që përfshiu në 1414 vëllezërit Gratiadei e Leon, djem të hebreut Solomon nga Vlora dhe një hebreu tjetër nga Korfuzi, Jobin, djali i Sabateut<sup>46</sup>. Ky i fundit vuante dënimin për sodomi në burgun e qeveritarit të Korfuzit, dhe prej andej kishte akuzuar për të njëjtin krim dy hebrejtë vlonjatë. Shënojmë se akuzat për sodomi, krahas akuzave për ritualin e gjakut, helmimin e ujit, shpërndarjes së murtajës apo përdhosjen e blateve (ostie), bënte pjesë në arsenalin e stereotipëve antisemitë gjatë mesjetës<sup>47</sup>. Në këtë kuptim, nuk dihet se me sa të drejtë ishte plasur në burg edhe vetë Jobi. Por, përsa i përket dy hebrejve të tjerë, Gratiadeit e Leonit nga Vlora, pas hetimeve dhe pas pohimeve të vetë Jobit, rezultoi se akuzat e këtij nuk kishin asgjë të vërtetë dhe se në themel të tyre qëndronte “urrejtja” familjare që ekzistonte “qysh së hershmi” mes dy familjeve hebreje (*propter odium quod ab antiquo et quasi naturaliter domus ipsius Job condemnati habuerat ad progenitores ipsorum supplicantium et domum suam*)<sup>48</sup>. Vëllezërit Gratiadei e Leon u liruan nga akuza dhe gjëja e parë që ata bënë ishte braktisja e Korfuzit dhe kthimi në strehën atërore në Vlorë, ku me sa duket kishte një mjedis më tolerant ndaj komunitetit të tyre.

<sup>45</sup> G. Veinstein, *Une source ottomane ...*, f. 384.

<sup>46</sup> G. Valentini, *Acta Albaniae Veneta*, pars II, tomus 7, f. 166.

<sup>47</sup> H. H. Ben-Sasson, *vep. e përm.*, f. 590-598, 861, 939.

<sup>48</sup> *Acta Albaniae Veneta*, pars II, tomus 7, f. 166.

*S u m m a r y*TRACES OF JEWISH PRESENCE IN ALBANIA DURING  
MEDIEVAL PERIOD

The largest presence of Jewish community in Albania is testified in the XV-XVI century, and it is certainly related with the Sephardic Diaspora that brought here Jewish groups from Spain and Spanish Sicily (1492). The ottoman registry of the property and the population of Vlora of the year 1591 -1520 shows that only in Vlora city, in that period 528 were Jewish, besides 945 Christian and 85 Muslim families out of 1558 families. Other registers make us believe that Jewish population of Berati and Vlora was reduced in size; a part of the families re-emigrated toward other imperial centers, in Thessalonica and Ioannina. The conversion occurrence in Islam of many Jewish people is testified in this period, a process that has known a high moment during the activity in Berati area, during the years 1666-1676, of "false messiah, heterodox Jewish and later converted Sabatah Zevi.

Jewish in Albania were present earlier than 16<sup>th</sup> century; at least since the end of the antique period, V-VI century, the epigraphic testimonies prove this fact. In the Byzantine period (VI-XIV century) in the coastal cities of Durres and Vlora it is always talked about individuals or Jewish communities, linked with trade (exercitium mercanties) and craftsmanship. It is worth mentioning the Jewish Community of Durres. This is testified in 1322 from English traveler Symeon Symeonis and it is confirmed by a document of 1417, evaluated from us for the first time where it is spoken for a special Jewish quarter of that city (Judaica Durachii). Jewish from Vlora and Durres kept preferential relations with the markets of Sicily and those of Venetian Republic. They exported special products as grains, silk or salt. The vendors exercised a kind of monopoly on salt, as sometimes they were obtruded even of the Angevine and Venetian governors, who attempted to have control over this profitable market.

The relations between Jewish and the local population are good testified. There is a lack of some anti-Semite signs, as were common in that period in the Christian Europe. Therefore, when a citizen from Durrës had the courage to bit a Jewish woman, his punishment was horrible; indeed he was punished pulling out one eye. On the contrary in Vlora or Durrës there are some testimonies of solidary attitude of the locals versus the Jewish community. Thus in 1401, a representative group of Durrës citizens, officially required to the Venetian Senate to exclude from the special tax *catasamiti* the Jewish people of the city, According to them, the Venetian government did not have any profit form this special tax because "Durrës Jewish were few and poor". This was not true, Durrës Jewish were neither few nor poor. The fact that Jewish people are continually appearing as testimonies and guaranties in the contracts between

other not Jewish citizens, shows for the Jewish treatment in Albanian cities. Furthermore it is worth mentioning the fact that Jewish were appointed important missions and tasks, as appointed ambassadors from the local authorities.